



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Parqeve
Periudha raportuese	Korrik, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatime Hajdari, Drejtore e Drejtorisë së Parqeve

1. **PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Parqeve përgjatë muajit korrik 2021, ka vazhduar realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për trajtimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Prishtinës.

2. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura", krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;
 - Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës;
 - Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë (përmes kontratës me NPB-në);
 - Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit për mbjelljet e drurëve dhe luleve shumëvjeçare;
 - Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);
 - Pranimi i informatave nga qytetarët, respektivisht nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;
 - Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave.

3. **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA** - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura", krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë sipas kontratës (përmes kontratës me NPB-në);
- Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave;
- Mbjellja e mbi 120 drurëve në Parkun Memorial në Velani - donacion i bankës NLB;
- Mbjellja e 14 drurëve afër shkollës "Gjergj Fishta - donacion i kompanisë "Celonis".

4. **AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR** - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;
- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;
- Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e parqeve rekreativo-sportive në lagjen "Dardania" (afër postës);
- Vazhdimi i renovimit dhe shndërrimit në hapësirë të gjelbër në Kompleksin "Qafa";
- Vazhdimi i renovimit të Parkut të qytetit "Dodona";

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

Për periudhën raportuese janë proceduar për pagesë:

4.1.3 Takimet me palë

Takimet me palë janë pjesë e procesit të punëve të përditshme.

- Janë realizuar takime në bazë të shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me: çështje të hapësirave të gjelbra dhe rigjenerimit të tyre.

5. Takimet me institucione të tjera -

-

6. Diskutime publike / takime me qytetarë

-

6.2. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.3. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Numri i lëndëve të pranuar: 8;

Numri i lëndëve të kryera: 4;

Numri i lëndëve të refuzuara: 1;

Numri i lëndëve të ceduara: 0;

Numri i lëndëve në proces: 3.

7. Takime të tjera

8. **SFIDAT** - Nëse gjatë zbatimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Gjatë realizimit të projekteve për këtë periudhë nuk kemi pasur pengesa për realizimin e tyre.

9. **REKOMANDIME** - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

Mundësia e plotësimit të stafit të zyrtarëve të dikasterit të Parqeve përmes procedurave të rekrutimit.

10. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES** - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";
- Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit;
- Mirëmbajtja e këndeve të lodrave (përmes kontratës me NPB-në);
- Përcjellja e punimeve të ndërtimit të parqeve rekreativo-sportive në lagjen "Dardania" (afër postës);
- Përcjellja e punimeve të projektit për renovimin e Parkut të qytetit "Dodona";
- Përcjellja e punimeve të renovimit dhe shndërrimit në hapësirë të gjelbër në Kompleksin "Qafa".

11. **TË TJERA** - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.